

VENDIM
Nr. 13, datë 31.10.2023

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË RREGULLOREN PËR PROCEDURAT
GJYQËSORE TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

më datë 31.10.2023, mori në shqyrtim projektin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese” dhe relacionin shoqërues të tij.

Mbledhja e Gjyqtarëve, në mbështetje të nenit 13, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve dhe shtesave në Rregulloren për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese për zbatimin dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 31.10.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska

Në Rregulloren për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 4, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Stema e Gjykatës përmban simbolin e shqiponjës dykrenore me ngjyrë të artë dhe të kuqe. Mbi kokat e shqiponjës është vendosur përkrenarja e heroit kombëtar Gjergj Kastriotit, Skënderbeut. Në zemër të shqiponjës është vendosur një medalje rrumbullake rreth e qark së cilës është shkruar Republika e Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese dhe nën të modelohen gjethe të dushkut

me ngjyrë jeshile. Në qendër të medaljes ngrihet mbi një sfond blu peshorja e drejtësisë. Në pjesën mbështetëse të peshores gdhendet “viti 1992”.”.

Neni 2

Në nenin 32, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Pjesëmarrësit në gjykim nuk përfitojnë nga e drejta për t’u njohur me aktet e ndërmjetme, ku përfshihen: aktet ose materialet e përgatitura nga këshilltari ose strukturat e tjera për qëllime të vendimmarrjes; shënimet e relatorit; projektvendimet; procesverbalet e vendimmarrjes dhe të votimit të gjyqtarëve.”.

Neni 3

Në nenin 28, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3.1 Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pjesëmarrësve në gjykim u kërkohet adresa e postës elektronike, në rast se nuk e kanë paraqitur më parë atë, me qëllim lehtësimin dhe realizimin e komunikimit deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor, përfshirë njoftimin për shpalljen e vendimit të arsyetuar të Gjykatës.”.

Neni 4

Në nenin 34, pika 3, shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) mosmbajtja e telefonit celular gjatë zhvillimit të seancës plenare. Përfshirë, palët mund të mbajnë pajisje të tjera elektronike (tablet, laptop ose të ngjashme me to) për të siguruar mbajtjen e shënimeve gjatë seancës dhe në funksion të mbrojtjes në gjykim.”.

Neni 5

Në nenin 42, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Pas përgatitjes së variantit përfundimtar të vendimit të Gjykatës, këshilltari ligjor ia përcjell Drejtorisë Gjyqësore dhe të Dokumentacionit, e cila merr masat për nënshkrimin e tij nga të gjithë gjyqtarët që kanë marrë pjesë në gjykim. Pas nënshkrimit të vendimit, Drejtoria Gjyqësore dhe e Dokumentacionit njofton për datën dhe orën e shpalljes së vendimit pjesëmarrësit në gjykim nëpërmjet postës elektronike, nëse ata kanë paraqitur adresën e saj ose me shkresë”.